



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë
Aktivitete dhe Trajnime 2020-2025

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në gjithë veprimtarinë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë.

Me misionin e tij, universiteti ka për qëllim: ***“nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin”.***

Plani Strategjik mbi Zhvillimin Profesional të Personelit 2023-2026 ka si qëllim të realizojë zhvillimin personal, profesional, trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe administrativ të UAMD-së, si dhe konsolidimin e kulturës së të mësuarit të vazhdueshëm.

Ky plan strategjik, është mbështetur në kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi, së bashku me dokumentet dhe prioritetet e UAMD-së. Roli koordinues i takon Qendrës për Kërkim dhe Ekselencë, duke u mbështetur nga Qendra për Edukim në Vazhdim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.

Zhvillimi personal, profesional, edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm për personelin akademik dhe administrativ i këtij universiteti është një proces i vazhdueshëm, nëpërmjet të cilit realizohet përditësimi i dijeve dhe aftësive të personelit akademik dhe administrativ. Në këtë kuadër është hartuar Plani Strategjik mbi Zhvillimin Profesional të Personelit 2023-2026 (Vendim Senati Nr.36 datë 07.07.2023 Prot. 1160/2).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENÇË

Aktiviteti 1

Në vitin 2020 Sekretariati i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (Regional Cooperation Council (RCC) nisi një Program të Mbështetjes së Ballkanit Perëndimor për të ndihmuar zhvillimin e infrastrukturave kërkimore në rajon, në kuadër të Planit Shumëvjeçar të Veprimit për një Zonë Rajonale Ekonomike (MAP REA) të miratuar në Samitin e Liderit në Korrik 2017 në Trieste. Një pjesë e MAP REA është përqendruar në heqjen e pengesave për lëvizjen e studentëve, studiuesve dhe akademikëve përmes politikave, masave dhe instrumenteve të përbashkëta që synojnë rritjen e lëvizshmërisë dhe bashkëpunimit akademik e kërkimor.

Në prill të vitit 2020, Sekretariati i RCC kontraktoi shërbime këshilluese të jashtme për të mbështetur zbatimin e Programit me dy qëllime specifike: (1) për të udhëhequr përgatitjen e politikave të Aksesit të Hapur (Open Access) për 30 Infrastruktura Kërkimore të zgjedhura në Ballkanin Perëndimor, konkretisht, Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova*, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, dhe (2) të trajnojë stafin drejtues, administrativ dhe hulumtues për të prezantuar parimet e Aksesit të Hapur për 30 Infrastrukturat Kërkimore të zgjedhura në Ballkanin Perëndimor. Programi RCC është krijuar jo vetëm që të kontribuojë në zhvillimin e praktikave të Aksesit të Hapur në Arsimin e Lartë dhe organizatat kërkimore publike në rajon, por do të hedhë themelet për krijimin e Rrjetit të Infrastrukturave të Aksesit të Hapur në Ballkanin Perëndimor, për të cilin RCC është pionier në rajon. Puna për hartimin e politikave të Aksesit të Hapur planifikohet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me stafin menaxhues, administrativ dhe kërkimor të Infrastrukturave Kërkimore të zgjedhura. UAMD është bërë pjesë e kësaj inisiative.

Gjatë **29 dhe 30 qershorit 2020**, u mbajtën dy ditë workshop online për të orientuar pjesëmarrësit në lidhje me iniciativën e Open Access Research Infrastructure. Kjo iniciative e RCC do të mbështesë me asistencë teknike institucionet e Arsimit të Lartë Publik, në rajonin e ballkanit perëndimor për draftimin e politikave për infrastrukturën kërkimore, të cilën dëshirojnë ta vënë në dispozicion të palëve të treta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENÇË

Aktiviteti 2

Më **16.10.2020** në ambientet e rektoratit të UAMD u realizua takimi i përbashkët me përfaqësues të MASR-së për Arsimin e Lartë, të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, dhe përfaqësues nga Qendra CVE. Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, në vijim të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, zhvilloi për periudhën Tetor-Dhjetor 2020 një sërë takimesh me universitetet në shkallë vendi. Qëllimi i këtyre takimeve bazohet tek nevoja për të diskutuar mbi masat dhe aktivitetet e mundshme që universitetet mund të ndërmarrin në kuadër të parandalimit të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm. Qendra CVE nxiti bashkëpunim e universiteteve në vend (publike dhe jo publike) me qëllim, dakordësimin e një marrëveshjeje ndërinstitucionale: Qendra CVE, Universitetet dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Aktiviteti 3

Maj 2021, pjesëmarrje e stafit të UAMD-së në trajnimin e organizuar nga Organizata SCIDEV dhe Universiteti i Tiranës ku u prezantua Anketa Sociale Evropiane/ European Social Survey (ESS) dhe Rrjeti Rajonal Western Balkans European Social Survey (WBESS). ESS është një vërtetim 2-vjeçar, në shkallë të gjerë, i qëndrimeve, besimeve dhe sjelljeve të popullatave në Europë që ka nisur në 2001 dhe aktualisht është në raundin e tij të 10-të. Ajo që e bën këtë vërtetim unik është metodologjia tejet rigoroze, që bën të mundur krahasimin e rezultateve mes vendeve pjesëmarrëse.

Të dhënat e ESS janë të disponueshme pa pagesë dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm për kërkuesit shkencorë dhe stafin pedagogjik. Ky trajnim u organizua në kuadër të aktiviteteve të Rrjetit Rajonal WBESS – rrjet i themeluar nga SUSTAIN II, një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit Horizon 2020, për të promovuar ESS në vendet e Ballkanit perëndimor. WBESS koordinohet nga Instituti i Shkencave Sociale në Beograd, dhe ka 23 anëtarë nga 15 shtete, nga të cilët dy anëtarët e vetëm nga Shqipëria janë SCIDEV dhe Universiteti i Tiranës. Në trajnimin e zhvilluar me datë 7-14 Maj 2021 morën pjesë 5 pedagogë të UAMD-së nga 20 pjesëmarrës nga gjithë universitetet e vendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Aktiviteti 4

Më 5.07.2021 u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës ndëruniversitare për kooperim me Euroazinë, Mesdheun dhe Afrikës Sub-Sahariane, Universiteti “La Sapienza”, Romë dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Marrëveshja konsiston në bashkëpunimin dhe shkëmbimin e studentëve të ciklit të tretë, trajnime të stafit dhe kërkuesve e profesorëve mes dy Institucioneve, si dhe projekte të përbashkëta dhe publikime me interes të përbashkët. Në këtë kuadër, në vitin akademik 2021-2022, në muajin Maj 2022 do të jetë prezent si vizitor për një javë Prof. Andrea Carteny ku do të mbajë leksione pranë Fakultetit të Edukimit.

Aktiviteti 5

Më 2.12.2021 pranë Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), Tiranë u nënshkrua nga Znj. Lejdi Dervishi, Drejtor dhe Prof. Dr. Kseanela Sotirofski Rektore e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, marrëveshja e bashkëpunimit mes dy Institucioneve. Kjo është marrëveshja e parë që Qendra nënshkruan me Institucione të Arsimit të Lartë në vend.

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është të mundësojë bashkëpunimin mes Palëve, në kuadër të përcaktimit të fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në mënyrë që të operojnë me efikasitet kundër sfidave dhe kërkesave të kohës si dhe në funksion të realizimit të qëllimeve dhe objektivave të përshkruara në Strategjinë Kombëtare “Për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”.

Objektivat e marrëveshjes janë: bashkëpunimi dhe kontributi në rritjen e ndërgjegjësimit mbi format e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm; njohja, hulumtimi dhe promovimi tek studentët i vlerave të tolerancës, paqes dhe bashkëjetesës së komuniteteve me diversitet kulturor, etnik, fetar etj; njohja dhe formimi profesional i kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit, psikologut, punonjësit social, juristit, administratës publike, gazetarisë, përmes gjetjeve të aktiviteteve kërkimore shkencore, mbi identifikimin e individëve dhe faktorët që nxisin radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në komunitet; praktikave studentore pranë QKEDH-së etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 1

- Mirëfunksionimi i Sekretarive të Njesisë Kryesore**

Mirëfunksionimi i sekretarive të fakulteteve	Personeli administrativ	QKE, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Drejtorja e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë	Tetor 2023
--	-------------------------	--	------------

⇒ **Rëndësia e Modulit të Trajnimi dhe Impaktin që do të Ketë tek Stafi i UAMD**

Rëndësia e këtij moduli është një mundësi përmirësimi e punës në të ardhmen, njohja e legjislacionit në fuqi, mbarëvajtjen e veprimtarive administrative, përcaktimi i prioritetëve, barazia, ruajtja e konfidencialitetit, etika në punë, pasurimi i dosjes personale.

Ky modul gjithashtu është një domosdoshmëri për mirëfunksionimin e procedurave të sekretarive në shërbim të studentit dhe stafit akademik.

Në kuadër të miratimit të “Planit strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit të Universitetit Aleksandër Moisiu”, sipas Moduli 1, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë zhvilluan në datën 25 tetor 2023 në Sallën e Konferencave, pranë godinës qendrore Currila një trajnim me fokus dhe temë “Mirëfunksionimi i sekretarive të njësive kryesore”.

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë më parë i dërgoi një email të gjithë stafit të sekretarive të njësive kryesore.

Trajnimi u shoqërua me bashkëbisedime të vlefshme mbi mundësitë e përmirësimit të punës në të ardhmen, njohjen e legjislacionit në fuqi (Ligji për Arsimin e Lartë, Kodi i Punës dhe Rregullorja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore), mbarëvajtjen e veprimtarive administrative, përcaktimin e prioritetëve, barazinë dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Në trajnim u diskutua mbi procesin e regjistrimit të studentëve ku përfshihen edhe procedurat e çregjistrimeve dhe transferimeve. Mbi plotësimin e regjistrimit themeltar të studentëve, plotësimin e regjistrimit të arritjeve akademike si dhe regjistrimit të lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

Në fund të procesit të trajnimit, u realizua një diskutim përmbyllës me pjesëmarrësit mbi efektivitetin e trajnimit dhe detyrat për të ardhmen.



**REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 1

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) publikoi me sukses numrin Vol. 10 No. 3 (2023): November 2023 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën 23.11.2023.

Në këtë numer u publikuan 19 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.



Trajnimi 2

- **Standardizimi i Punimeve Shkencore. Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare që Financojnë Kërkimin Shkencor, Inovacionin**

Standardizimi i punimeve shkencore. Programet kombëtare dhe ndërkombëtare që financojnë kërkimin shkencor, inovacionin	Personeli akademik	QKE, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ekspert i jashtëm.	Dhjetor 2023
---	-----------------------	--	-----------------

⇒ **Rëndësia e modulit të trajnimit dhe impakti që do të ketë tek stafi akademik:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Njohja e stafit akademik me standardizimin, cilësinë dhe metodat inovative në punimet shkencore dhe akademike është një domosdoshmëri për stafin akademik. Ajo u mundëson veçanërisht atyre që janë në kërkim të gradave dhe titujve shkencorë të përvetësojnë sa më mirë standardet e kërkuara në punimet shkencore, të publikuara në revista të njohura brenda dhe jashtë vendit. Njëkohësisht njohja me programet kombëtare dhe ndërkombëtare që financojnë kërkimin shkencor u mundëson atyre qasjen në këto projekte, në mënyrë që të zhvillojnë akoma më tepër kapacitetet e tyre kërkimore në të mirë të mësimdhënies dhe rritjes së tyre profesionale.

Programet kombëtare dhe ndërkombëtare luajnë një rol vendimtar në financimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit. Këto programe ofrojnë fonde dhe burime për të mbështetur projektet kërkimore, zhvillimin e infrastrukturës dhe rritjen profesionale të stafit akademik.

Në kuadër të miratimit të “Planit strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit të Universitetit Aleksandër Moisiu”, sipas **Modulit 2** Qendra për Kërkim dhe Ekselencë në bashkëpunim me Zv.Rektorin për Kërkimin Shkencor dhe Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë me të ftuar Profesor Marco Cilento, Universiteti “La Sapienza” Itali zhvilluan më 19 dhjetor 2023 në Sallën e Konferencave, Godina 2 në Kampusin Universitar një trajnim për stafin akademik me temë “Standardizimi i punimeve shkencore. Programet kombëtare dhe ndërkombëtare që financojnë kërkimin shkencor dhe inovacionin”. Qendra për Kërkim dhe Ekselencë më parë i dërgoi një formular të gjithë stafit akademik të të gjithë Fakulteteve duke marrë një feedback prej 72 përgjigjesh të interesuar për të marrë pjesë në trajnim.


Trajnimi u shoqërua me bashkëbisedime të vlefshme mbi strategjitë kombëtare dhe inovacionin, standardet e punimeve shkencore, sistemin antiplagjaturë dhe aksesueshmërinë në revistat shkencore.

Profesor Cilento referoi mbi eksperiencën e La Sapienzas në kërkime ndërkombëtare si Horizon Europe dhe Programe të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në fund të trajnimit u zhvillua një diskutim mbi efektivitetin e seancës së trajnimit dhe problematikat e hasura më parë nga të pranishmit, përvetësimi i njohurive dhe nevojat për të dhëna dhe informacione të mëtejshme në të ardhmen për ta.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 2

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) publikoi me sukses numrin Vol. 10 No. 3 S! (2023): Special Issue, December 2023 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën 23.12.2023.

Në këtë numër u publikuan 14 artikuj me autorë vendas.



Trajnimi 3

- **Barazia dhe Diversiteti**

Barazia dhe diversiteti	Personeli akademik dhe administrativ	QKE dhe Qendra për Edukim në Vazhdim.	Mars 2024
-------------------------	--------------------------------------	---------------------------------------	-----------

⇒ **Rëndësia e Modulit të Trajnimit dhe Impaktin që do të ketë tek Stafi i UAMD**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Moduli i trajnimit “Barazia dhe diversiteti” ka qëllim të sigurojë që UAMD, stafi akademik dhe administrativ, të ofrojnë një mjedis të sigurt për të gjithë studentët. Ky modul synon të rrisë njohuritë dhe ndërgjegjësojë stafin akademik dhe administrativ për barazinë dhe diversitetin. Rëndësia e këtij trajnimi është e lidhur ngushtë me njohjen e legjislacionit sa i takon diskriminimit; Ndërgjegjësimin për respektimin e studentëve me aftësi të kufizuar dhe diversitet etno-kulturor si dhe për të nxitur një kulturë demokratike gjithëpërfshirëse në auditor; Aftësimi individual për mënyrat e trajtimit të konflikteve në një mjedis me diversitet etno-kulturor; Njohja me format e komunikimit dhe ndërveprimit në mjedisin mësimor me prani të nxënësve me aftësi ndryshe dhe diversitet etno-kulturor. Trajnimi u shoqërua me bashkëbisedime të vlefshme dhe një prezantim nga lektorja Matilda Likaj me fokus “Prezenca ekzekutive në punë”.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 3

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) publikoi me sukses numrin Vol. 11 No.1 (2024): March 2024 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën 23.03.2024.

Në këtë numër u publikuan 28 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.



Trajnimi 4

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike (FSHPJ), gjatë muajit prill 2024, organizoi kursin multidisiplinar “Bashkimi Europian dhe Shqipëria: Kuptimi i Demokracisë, Komunikimi dhe Integrimi”, në kuadër të projektit Jean Monnet Module. Ky modul iu ofrua studentëve të programeve të ndryshme studimore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, të cilët treguan interes të lartë dhe pjesëmarrje aktive gjatë gjithë zhvillimit të kursit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 4

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) publikoi me sukses numrin Vol. 11 No.1 S 1 (2024): Special Issue April 2024 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën 23.04.2024.

Në këtë numër u publikuan 36 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.



Trajnimi 5

- **Organizimi i Brendshëm Institucional, Statuti dhe Rregullorja e UAMD**

Organizimi i brendshëm institucional, Statuti dhe Rregullorja e UAMD	Personeli akademik	QKE, Qendra për Edukim në Vazhdim dhe Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë	Maj 2024
--	--------------------	--	----------

⇒ **Rëndësia e modulit të trajnimit:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË


Njohja me organizimin institucional, është një nga detyrat primare të stafit akademik, sidomos të të punësuarve rishtaz. Stafit akademik duke u njohur me procedurat administrative përcaktuar në Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së, do t'i lehtësohet puna në zbatimin e detyrave dhe përmbushjen e afateve kohore të përcaktuara.

Në kuadër të miratimit të “Planit strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit të Universitetit Aleksandër Moisiu”, sipas Modulit 4, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë në bashkëpunim me Qendrën për Edukim në Vazhdim dhe Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë zhvilluan në datën 31 maj 2024 në Sallën e Konferencave, Kampusit një trajnim me fokus dhe temë “Organizimi i brendshëm institucional, Statuti dhe Rregullorja e UAMD”.

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë kishte dërguar më parë një email të gjithë stafit akademik ku prezenca e stafit akademik të emëruar në 3 vitet e fundit ishte e rekomanduar.

Trajnimi u shoqërua me bashkëbisedime të vlefshme mbi angazhimin e stafit në komisione të ndryshme. (Për përzgjedhjen e kandidatëve në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve, për përzgjedhjen e kandidatëve me status të veçantë, transferimet dhe programet e dyta të studimit, për mbrojtjen e temave të diplomave etj.) dokumentacioni përkatës.

Në trajnim u diskutua mbi Rregulloren e Uamd-së, njohjen me Statutin dhe Legjislacionin. Në përfundim të procesit të trajnimit, u zhvillua një diskutim me stafin e ri mbi pyetjet e paqarta që ata kishin lidhur me çështje të ndryshme, ku ende kishin pasiguri.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 5

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) publikoi me sukses numrin Vol. 11 No.2 (2024): July 2024 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën 29.07.2024.

Në këtë numër u publikuan 14 artikuj me autorë vendas.



Trajnimi 6

- **“Funksionimi i IAL-ve dhe Procedurat Administrative të Njësive Bazë dhe Njësive Kryesore”**

“Funksionimi i IAL-ve dhe Procedurat Administrative të Njësive Bazë dhe Njësive Kryesore”	Personeli administrativ	QKE, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorinë e Administrimit dhe të Shërbimeve Akademike	Shtator 2024
---	-------------------------	---	--------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Më 25 shtator 2024, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD), organizoi një workshop informues në ambientet e tij në Sallën e Konferencave 310 Currila. Aktiviteti u organizua nga **Qendra për Kërkim dhe Ekselencë** në bashkëpunim me **Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë, Drejtorinë e Administrimit dhe të Shërbimeve Akademike, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, si dhe Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

Ky event kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe optimizimin e proceseve administrative, si dhe përmirësimin e funksionimit të njësive akademike të universitetit.

Workshop-i u zhvillua me temën qendrore: "Funksionimi i IAL-ve dhe Procedurat Administrative të Njësive Bazë dhe Njësive Kryesore", ku drejtuesit dhe pjesëmarrësit diskutuan mbi mënyrat për përmirësimin e procedurave administrative dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet njësive të ndryshme akademike dhe administrative të universitetit.

Temat e diskutuara gjatë workshop-it:

1. Fjala përshëndetëse e Rektorit Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

Rektori i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, hapi workshop-in duke theksuar rëndësinë e një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet njësive bazë dhe njësive kryesore, si një mënyrë për të garantuar efikasitetin në proceset akademike dhe administrative të universitetit. Ai nënvizoi se ky workshop ishte një mundësi e shkëlqyer për të reflektuar mbi përmirësimin e proceseve ekzistuese dhe për të ndarë eksperiencat më të mira.

2. Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE)

Prezantimi i kësaj qendre përfshinte njohjen e pjesëmarrësve me format dhe mundësitë e bashkëpunimit në fushën e kërkimit shkencor. QKE gjithashtu prezantoi procesin e publikimit të punimeve shkencore dhe aktiviteteve në revistën ndërkombëtare **IJRD** (*International Journal of Research and Development*), duke inkurajuar stafin akademik të angazhohet më shumë në kërkim shkencor dhe publikime ndërkombëtare.

3. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë

Gjatë këtij sesi u diskutuan procedurat administrative të njësive akademike, përfshirë përditësimin e stafit drejtues me bazën ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e këtyre njësive. U ndanë eksperiencat pozitive dhe praktikatat më të mira në funksionet e ndryshme të drejtimit dhe administrimit të njësive bazë dhe kryesore. Ky sesion përfshiu edhe çështjet lidhur me **riorganizimin dhe akreditimin** e programeve të studimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike

Kjo drejtori ofroi një prezantim mbi proceset e rekrutimit dhe mënyrën e administrimit të dokumentacionit të personelit. Diskutimi përfshiu edhe çështjet e menaxhimit të dosjeve të personelit dhe përmirësimin e procedurave të brendshme për të siguruar një shërbim më efikas për stafin akademik dhe administrative.

5. Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike

Kjo drejtori prezantoi funksionet dhe përgjegjësitë e saj, duke theksuar rolin që luan në mbështetjen e njësive akademike dhe administrimin e shërbimeve për studentët dhe stafin. Diskutimi u fokusua në krijimin e një rrjeti të fortë komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe identifikimin e mundësive për përmirësim të mëtejshëm në ofrimin e shërbimeve akademike dhe administrative.

6. Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Gjatë kësaj pjesë të workshop-it, u prezantuan objektivat strategjike për ndërkombëtarizimin e universitetit dhe procedurat e aplikimit për projekte ndërkombëtare. U diskutua rëndësia e angazhimit të universitetit në projekte ndërkombëtare për të forcuar pozicionin e tij në rajon dhe për të krijuar mundësi të reja për stafin dhe studentët.

7. Diskutime dhe reflektime

Në fund të aktivitetit, u zhvillua një sesion diskutimi ku pjesëmarrësit ndanë përvojat e tyre dhe propozuan ide për përmirësimin e mëtejshëm të procesit administrativ dhe akademik në universitet. Ky sesion kishte si synim të mbledhë sugjerime praktike dhe të nxisë bashkëpunimin më të gjerë ndërmjet njësive.

Workshop-i përfundoi me një frymë optimizmi dhe një angazhim të përbashkët për të përmirësuar mënyrën e funksionimit të njësive brenda universitetit, duke u fokusuar në rritjen e efektivitetit dhe integrimin e strukturave të ndryshme administrative dhe akademike.



**REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 7

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) mori pjesë në seminarin kombëtar të organizuar nga Zyra Kombëtare Erasmus+ në bashkëpunim me grupin e Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë – HERE me temë: “Nevojat dhe Zhvillimi i Instrumentave rreth Etikës mbi Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin në Shqipëri. Seminari u zhvillua më 20–21 nëntor 2024, në ambientet e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Ky aktivitet mbledhi së bashku anëtarë të stafeve akademike nga institucionet e arsimit të lartë (IAL) të Tiranës, Korçës, Shkodrës, Gjirokastrës, Elbasanit, Vlorës, Durrësit, etj.; përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë; përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë; institute kërkimore shkencore, si dhe ekspertë të fushës.

Qëllimi i seminarit ishte mbledhja e kontributeve të drejtpërdrejta në mbështetje të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, me synimin për të krijuar një kuadër më të

mirë mbi kërkimin shkencor dhe inovacionin, përmes zhvillimit dhe funksionimit të instrumenteve përkatëse dhe aplikimit të standardeve kombëtare në etikën e kërkimit shkencor, në nivel institucional.

Publikimi 6

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) publikoi me sukses numrin Vol. 11 No. 3 (2024): November 2024 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën 03.12.2024.

Në këtë numër u publikuan 31 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 8

Inteligjenca Artificiale dhe Teknologjitë Digjitale: Rruga drejt Inovacionit në Mësimdhënie	Personeli akademik	QKE, ekspertë të fushës	Dhjetor 2024
---	-----------------------	-------------------------------	-----------------

Më datë 17 dhjetor 2024, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë, organizoi me sukses workshopin me temë: **“Inteligjenca Artificiale dhe Teknologjitë Digjitale: Rruga drejt Inovacionit në Mësimdhënie”**. Ky workshop kishte synim të fuqizonte njohuritë dhe aftësitë e stafit akademik të UAMD-së për të integruar teknologjitë e avancuara në procesin e mësimdhënies.

Ekspertët dhe trajnerët që ndanë përvojën e tyre ishin:

- **Z. Dejan Kushta** – Ekspert në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Universiteti i Tiranës.
- **Prof. Asoc. Dr. Emilda Roseni** – Eksperte në vlerësim dhe metodologji të mësimdhënies, me përvojë ndërkombëtare, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.
- **Prof. Asoc. Dr. Shqipe Haxhihyseni** – Eksperte e pedagogjisë me mbi 35 vite përvojë në arsim, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës.

Pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime dhe aktivitete interaktive, duke marrë ide praktike për aplikimin e teknologjive digjitale në procesin e mësimdhënies. Workshop-i shënoi një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit në UAMD dhe rritjes së kompetencave teknologjike të stafit akademik.

Temat kryesore të diskutimit:

- **Mundësitë dhe sfidat e teknologjisë digjitale dhe inteligjencës artificiale në mësimdhënie**, përfshirë përdorimin e mjeteve si *Glarity*, *Explainpaper*, *QuillBot*, *ChatGPT*, *Mentimeter*, etj.
- **Zhvillimi i metodologjive të reja të mësimdhënies** për përfshirjen aktive të studentëve në procesin mësimor.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË



Publikimi 7

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) publikoi me sukses numrin **Vol. 12 No. 1 (2025): March 2025** të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën **25.03.2025**. Në këtë numër u publikuan 26 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 9

Aspekte praktike të aplikimit dhe pjesëmarrjes në programet COST (Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji).	Personeli akademik	QKE, ekspertë të fushës	Maj 2025
---	--------------------	-------------------------	----------

Më 22 maj 2025, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë organizoi workshop-in me temë: “Aspekte praktike të aplikimit dhe pjesëmarrjes në programet COST (Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji)”.


Workshop-i u përshëndet nga Zv. Rektorja për Kërkimin Shkencor, Prof. Dr. Azeta Tartaraj, dhe ofroi mundësi të vlefshme praktike për stafin akademik në drejtim të aplikimit në thirrjet e hapura të COST-it.

Përvojat konkrete të lektorëve tanë, tashmë ekspertë në projektet COST, u pritën me shumë interes dhe u vlerësuan maksimalisht nga pjesëmarrësit.

Në kuadër të hapjes së shpejtë të thirrjeve të reja për 70 programe COST, workshopi ofroi mundësi shumë të mira praktike për stafin akademik, për të aplikuar dhe marrë pjesë në **Management Committee** dhe **Working Groups**.

Lektorë të ftuar:

- Dr. Ariola Harizi
- Dr. Mirela Tase
- Dr. Spiro Paco
- Prof. Asoc. Ekaterina Strati





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË



Trajnimi 10

Më 13 qershor 2025, **Qendra për Kërkim dhe Ekselencë**, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike (FSHPJ), organizoi për të dytin vit radhazi kursin multidisiplinar “Bashkimi Europian dhe Shqipëria: Kuptimi i Demokracisë, Komunikimi dhe Integrimi”, në kuadër të projektit Jean Monnet Module.

Ky modul iu ofrua studentëve të programeve të ndryshme studimore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, të cilët treguan interes të lartë dhe pjesëmarrje aktive gjatë gjithë zhvillimit të kursit.

Në përfundim të kursit, studentët u pajisën me certifikata pjesëmarrjeje të Jean Monnet Module, si dëshmi e angazhimit dhe përvetësimit të njohurive mbi proceset demokratike dhe integrimin europian.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 8


Qendra për Kërkim dhe Ekselencë publikoi me sukses numrin Vol. 12 No. 1 S1 (2025): June 2025 - Special Issue, të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën **25.06.2025**. Në këtë numër u publikuan 41 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.



Trajnimi 11

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) mori pjesë në trajnimin e organizuar nga OPEN COST Action, i zhvilluar më 26–28 qershor 2025, me temë: “Academics in Europe: Challenges of Self-Censorship, Academic Security and Wellbeing”.

Trajnimi u fokusua në sfidat me të cilat përballen akademikët në Evropë, si vetëcensura, siguria akademike dhe mirëqenia mendore. Gjatë aktivitetit, u zhvilluan sesione praktike me ekspertë të fushës, të cilët trajtuan mënyra për ndërtimin e qëndrueshmërisë profesionale dhe personale në një mjedis akademik gjithnjë e më kompleks.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 9

Qendra për Kërkim dhe Ekselencë publikoi me sukses numrin Vol. 12 No. 2 (2025): July 2025 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën **01.08.2025**. Në këtë numer u publikuan 14 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.



Trajnimi 12

QKE mori pjesë në trajnimin e organizuar nga AADF dhe Brussels Academy, në Tiranë në datat 9-11 Shtator 2025 me temë *“Hands-on Erasmus + training based on a real funded project, focused on writing and managing successful proposals”*.



	University	Research Center	Industry	Dissemination partner
Project 1	10	5	2	
Project 2	10	12	3	
Project 3	3	2	2	
Project 4	3	3	3	12
Project 5	4	4	1	
Project 6	12	2	2	2
Total	50	36	15	14
average monthly cost	3,000	3,000	4,000	5,000
	150,000	108,000	60,000	49,000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 13

Më 22–26 shtator 2025, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike (FSHPJ), organizoi “Shkollën Verore” në kuadër të projektit Jean Monnet Module EUALB: “Bashkimi European dhe Shqipëria – Kuptimi i Demokracisë, Komunikimit dhe Integritetit” (Ref. No. ERASMUS-JMO-MODULE-2023-MODULE-101127808).

Leksionet u mbajtën nga profesorë të njohur nga Shqipëria, Italia dhe Polonia, të cilët ndanë përvoja dhe njohuri të vlefshme me studentët pjesëmarrës, duke krijuar një atmosferë ndërkulturore dhe akademike të pasur.

Studentët e përzgjedhur për pjesëmarrje në këtë program u pajisën me certifikata zyrtare në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi European, si dëshmi e angazhimit të tyre dhe përvetësimit të njohurive mbi proceset demokratike dhe integrimin europian.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 14

Inteligjenca Artificiale, Integriteti Akademik dhe e Ardhmja e Ndërkombëtarizimit të Arsimit të Lartë: Ndërtimi i Besimit në Epokën Digjitale	Personeli akademik/administrativ	QKE, FTI	Tetor 2025
---	----------------------------------	----------	------------

Më 27 Tetor 2025, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit organizuan një workshop të suksesshëm, i cili përfshiu stafin akademik dhe administrativ të Universitetit “Aleksandër Moisiu”. Tema kryesore e workshop-it ishte ndikimi i Inteligjencës Artificiale (AI) në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë, me fokus te integriteti akademik, njohja e diplomave dhe ndërtimi i besimit në epokën digjitale.

Gjatë sesionit, lektorja e ftuar, Znaj. Edlira Adi Kahani Subashi, ndau përvojën dhe njohuritë e saj të thella për politikat evropiane të arsimit dhe ndikimin e AI në mobilitetin akademik dhe sigurinë e cilësisë së kualifikimeve akademike. Ajo theksoi rëndësinë e sistemeve digjitale dhe sigurisë në krijimin e një mjedisi të besueshëm dhe transparent në arsimin e lartë.

Çështjet që u trajtuan gjatë workshop-it:

- Roli i Inteligjencës Artificiale në njohjen akademike ndërkufitare
- Krijimi i besimit përmes sistemeve digjitale dhe sigurimit të cilësisë
- Kuadri ligjor dhe etik në Evropë: Akti për AI dhe ETINED- ndarja e praktikave më të mira në fushën e transparencës dhe integritetit në arsim
- Mundësitë për përfshirje dhe mobilitet të barabartë në Ballkanin Perëndimor
- Rreziqet dhe integriteti në ekosistemin digjital arsimor
- Roli i studentëve dhe stafit në ndërtimin e një kulture të drejtë dhe transparente të përdorimit të AI në arsim


Pjesëmarrësit e workshop-it treguan një interes të lartë dhe morën pjesë aktive në diskutimet dhe shqyrtimet mbi mundësitë dhe sfidat që paraqet AI për arsimin e lartë, si dhe mbi rëndësinë e ruajtjes së integritetit akademik në një epokë digjitale gjithnjë e më të avancuar. Ky workshop ofroi mundësi të shkëlqyera për stafin akademik dhe administrativ për të kuptuar më mirë si mund të integrohet Inteligjenca Artificiale në proceset akademike dhe për të kontribuar në ndërtimin e një arsimi të lartë të qëndrueshëm dhe të besueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË



Workshop/ Inteligjenca Artificiale, Integriteti
Akademik dhe e Ardhmja e
Ndërkombëtarizimit të Arsimit të Lartë:
Ndërtimi i Besimit në Epokën Digjitale



Workshop/ Inteligjenca Artificiale, Integriteti
Akademik dhe e Ardhmja e
Ndërkombëtarizimit të Arsimit të Lartë:
Ndërtimi i Besimit në Epokën Digjitale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 15

Workshop Informues për Aplikim në Programet Erasmus+ dhe Horizon Europe	Personeli akademik dhe administrativ	QKE, Drejtorinë e Projekteve, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Agjencia PMable	Nëntor 2025
---	--------------------------------------	---	-------------

Më 12 Nëntor 2025, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë të Universitetit të Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD), organizuan një workshop informues me fokus në mundësitë e aplikimit në programet Erasmus+ dhe Horizon Europe. Workshopi u zhvillua në Salla e Konferencave, Currila, dhe ka pasur për qëllim të ofrojë njohuri dhe këshilla praktike për stafin akademik dhe administrativ të universitetit, si dhe për çdo pjesëmarrës të interesuar në mundësitë e këtyre dy programeve ndërkombëtare.

Workshopi u zhvillua në kuadrin e përpjekjeve për të rritur ndërveprimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të universitetit, duke mundësuar që të krijohet një mjedis ku studentët, hulumtuesit, dhe profesionistët të mund të aplikojnë për projekte të rëndësishme dhe të shfrytëzojnë mundësitë e financimit për aktivitete kërkimore dhe edukative.

Temat Kryesore të Trajtuar gjatë Workshomit:

- **Prezantimi i mundësive të financimit të programeve Erasmus+ dhe Horizon Europe:** Si mund të aplikoni dhe cilat janë kriteret përkatëse.
- **Përfitimet e pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare:** Mundësitë e rritjes së kapaciteteve kërkimore dhe akademike përmes bashkëpunimeve ndërkombëtare.
- **Procesi i aplikimit për Erasmus+ dhe Horizon Europe:** Këshilla dhe rekomandime për përgatitjen e aplikimeve të suksesshme.
- **Shembuj të praktikave të suksesshme:** Pjesëmarrësit morën mundësinë të dëgjojnë dhe diskutojnë histori suksesi të projekteve që kanë marrë mbështetje nga këto programe.
- **Ndihma për ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare:** Si të krijoni mundësi për bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Evropë dhe përtej.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Workshopi u udhëhoq nga përfaqësues të Agjencisë PMable, e cila është pjesë e grupit Value Provider dhe ofron shërbime të menaxhimit të projekteve dhe konsulencës për individë dhe kompani. Ekspertët e PMable ndanë përvojën e tyre të gjerë në menaxhimin e projekteve ndërkombëtare dhe ofruan këshilla konkrete për stafin akademik dhe administrativ të universitetit, si dhe për ata që janë të interesuar të aplikojnë në këto programe prestigjioze.

Pjesëmarrësit e workshopit shfaqën një interes për mundësitë që ofrojnë programet Erasmus+ dhe Horizon Europe, duke marrë pjesë aktive në diskutime dhe duke bërë pyetje lidhur me mundësitë e financimit dhe kërkesat specifike të aplikimit. Ky workshop ka krijuar mundësi të reja për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka ofruar një platformë për shkëmbimin e njohurive dhe ideve mes të gjithë pjesëmarrësve.

Ky workshop ofroi mundësi për stafin akademik dhe administrativ të Universitetit të Aleksandër Moisiu për të mësuar më shumë rreth mundësive të aplikimit në programet Erasmus+ dhe Horizon Europe dhe për të marrë këshilla të vlefshme nga ekspertët në këtë fushë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Publikimi 10


Qendra për Kërkim dhe Ekselencë publikoi me sukses numrin Vol. 12 No. 3 (2025): November 2025 të revistës shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development (IJRD) në datën 26.11.2025. Në këtë numër u publikuan 35 artikuj me autorë vendas dhe të huaj.



Trajnimi 16

Më 4 dhjetor 2025, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë (QKE) mori pjesë në workshop-in online të organizuar në bashkëpunim me Scopus dhe Scopus AI, me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale në përdorimin sa më efikas të platformës Scopus.

Workshop-i u fokusua në prezantimin e funksionaliteteve kryesore të platformës dhe në mënyrat e shfrytëzimit të saj nga drejtuesit akademikë dhe strukturat mbështetëse për kërkimin shkencor. Aktiviteti u zhvillua me pjesëmarrjen e drejtuesve të njëjësive kryesore dhe bazë, si dhe stafit të QKE-së, me synimin që njohuritë e përfituara të përcillen më tej përmes sesioneve të brendshme informuese për stafet akademike.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENCË

Trajnimi 17

Në datat 16, 17 dhe 18 Dhjetor 2025, u realizua me sukses trajnimi online mbi temën "Project Writing", i organizuar nga Qendra për Kërkim dhe Ekselencë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Projekteve dhe Marrëdhëniet me Jashtë, dhe i ofruar nga kompania PMable sh.p.k.

Gjatë këtyre tre ditëve të trajtimit intensiv, ekspertët e fushës kanë ofruar njohuri dhe teknika të avancuara në menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve. Trajnimi përfshiu trajtimin e disa çështjeve kyçe dhe thelbësore, të cilat janë të rëndësishme për suksesin e çdo projekti, siç janë:

- Hyrje në Ciklin e Projektit & Struktura e Propozimit: Pjesëmarrësit morën një kuptim të plotë të procesit të zhvillimit të projekteve, nga faza e konceptimit deri në implementimin e suksesshëm. U diskutua se si një ide akademike mund të transformohet në një projekt konkret dhe të realizueshëm, duke krijuar një lidhje të ngushtë mes teorisë dhe praktikës.
- Hartimi i Objektivave dhe Indikatorëve (Logical Framework Approach): U analizuan teknikat për ndërtimin e objektivave të qarta dhe të matshme për projektet, duke u fokusuar në përdorimin e metodologjisë Logical Framework Approach (LFA) për hartimin e propozimeve të projektit. Po ashtu, u theksuan konceptet e objektivave SMART dhe rëndësia e përdorimit të indikatorëve për monitorimin e avancimit të projektit.
- Buxheti Praktik: Një nga aspektet më të rëndësishme të menaxhimit të projekteve është ndërtimi i një buxheti të saktë dhe të qëndrueshëm. Trajnimi ofroi një përjasje praktike dhe profesionale për hartimin e një buxheti të plotë, duke përfshirë metodat e vlerësimit të kostove dhe ndarjen e burimeve financiare.
- Monitorimi dhe Vlerësimi (M&E): U diskutua rëndësia e një plani të mirëfilltë për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të projektit. Pjesëmarrësit u mësuan se si të zhvillojnë sisteme efektive të monitorimit dhe vlerësimit që sigurojnë përmbushjen e objektivave dhe qëndrueshmërinë e projekteve të zhvilluara.

Përmes diskutimeve të thelluara dhe ndarjes së eksperiencave konkrete, u konstatua se kontributi i stafit akademik dhe profesionistëve është i paçmuar në zhvillimin e shoqërisë dhe akademisë. Ata janë shtylla kyçe për avancimin e inovacionit, si dhe për realizimin e ndryshimeve pozitive dhe afatgjata në fushën e projekteve.

Në përfundim, u falënderuan të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe energjinë e treguar gjatë këtij trajnimi. Pjesëmarrësit dhanë një kontribut të vlefshëm në arritjen e objektivave dhe bënë diskutimet më produktive dhe të dobishme. Ky bashkëpunim ka qenë i rëndësishëm për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe do të kontribuojë në zhvillimin e vazhdueshëm të fushës së menaxhimit të projekteve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS
QENDRA PËR KËRKIM DHE EKSELENÇË

